

Pyetje dhe përgjigje

Thirrja për Grante të Dedikuara (16510-G01)

1. Si duhet të jetë qasja e idesë së propozuar? A mund të vijnë ide nga një organizatë me eksperiencë në çështje sociale?

Kjo thirrje është e hapur për të gjitha llojet e organizatave, varësisht fushës së tyre të veprimit por nisma me të cilën ata vijnë duhet të jetë mjedisore (trajton ndryshimet klimatike, ndotjen ose mbrotjen e natyrës) ose ndërsektoriale duke ndërthurur çshtjet mjedisore me ato sociale, ekonomike ose ligjore.

2. A mundet organizatat përfituese në skemat e tjera të granteve të projektit të GreenAL të përfitojnë?

Organizatat përfituese në skemat e tjera të granteve si pjesë e projektit GreenAL mund të aplikojnë por prioritet në këtë thirrje do të kenë ato organizata, të cilat nuk janë përfituese të një granti nga projekti.

3. A mundet që projekti të zgjasë vetëm një muaj?

Jetëgjatësia e projekteve është parashikuar 6 muaj dhe jo nuk mund të zgjasë vetëm një muaj që nga momenti që nënshkruhet kontrata me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

4. Cilat janë shpenzimet e palejueshme?

Referohuni [udhëzuesit](#) lidhur me shpenzimet e lejuara dhe të palejuara në kuadër të thirrjes për grante të dedikuara. Megjithatë, ju do të informoheni lidhur me shpenzimet e palejuara gjatë punësive që do të kemi dhe veçanërisht punëtorisë mbi “Shkrim Projekti”.

5. A mund të aplikohet me më shumë se 1 ide?

Ne nuk ju inkurajojmë që të dërgoni më shumë se 1 ide. Nëse ndodh që do dërgoni më shumë se 1, nuk do të skualifikoheni por ne do të vlerësojmë ose do të marrim në shqyrtim idenë e parë me të cilën ju keni aplikuar dhe ideja e dytë nuk do të konsiderohet.

6. Në rast se një aktivist/e i bashkohet një shoqate, a mund të vihet ai/ajo si person kontakti sa i takon koncept idesë?

Një aktivist nuk mund të aplikojë i vetëm por duhet të aplikojë bashkë me një organizatë dhe aktivisti inkurajohet që të jetë personi i kontaktit përsa i takon nismës. Kështu që PO mund të jetë person kontakti.

7. Sa është numëri i granteve fituese?

Numëri i granteve fituese do të jetë 7 grante në të gjithë Shqipërinë.

8. A mund të aplikojmë edhe si individ apo vetëm si Organizatë?

Vetëm organizatat përfshi këtu Grupet Vendore të Veprimit (GVV) mund të aplikojnë. Individët nuk mund të aplikojnë si një entitet i vetëm.

9. Kur parashikohet fillimi i zbatimit të granteve?

Parashikojmë që zbatimi i granteve të fillojë jo më larg se Shtator 2025.

10. Aktivisti duhet të jetë i regjistruar? Cili është roli i aktivistit?

Aktivisti është një qytetarë/e, i/e cili/a ka identifikuar një problematikë mjedisore në komunitetin ku jeton dhe dëshiron ta adresojë atë. Por, aktivisti/ja, nuk mund të aplikojë vetëm (edhe pse mund të jetë i/e rregjistruar me NIPT) duhet patjetër të vijë me një organizatë të shoqërisë civile. Roli i aktivistit pritet të jetë ai i personit të kontaktit por kjo edhe në varësi të marrveshjes që mund të jetë dakordësuar midis dy palëve (aktivistit/es vs organizatë).

11. Organizatat që kanë aplikuar tek grantet rajonale, mund të aplikojnë në këtë thirrje?

Po, organizatat që kanë aplikuar tek grantet rajonale mund të aplikojnë.

12. Kohëzgjatja e nismës është deri në 6 muaj (pra mund të jetë më pak p.sh 4 muaj) apo duhet saktësisht 6 muaj?

Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë 6 muaj për t'ju dhënë mundësinë përfituesve të granteve që të bëhen pjesë e të gjitha proceseve kapacituese parashikuar nga kjo skemë grantesh dhe projekti GreenAL.

13. Sa % e fondit total mund të përdoret për burimet njerëzore?

Në fazën e aplikimit nuk ju kërkohet që të dorëzoni buxhet për nismën me të cilën do të aplikoni. Më shumë mbi çështjet e buxhetit do të informoheni në punëtorinë që do të organizohet për këtë qëllim.

14. Kush mund të aplikojë në termat e eksperiencës?

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile mund të aplikojnë por nisma me të cilën do të aplikohet duhet të adresojë një çështje mjedisore ose ndërsektoriale (trajton një sfidë mjedisore të ndërthurur me një problem social, ekonomik ose ligjore).